

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE**  
**D & BILL SHPK**

Sot, më datë 10/10/2024, në Tiranë,

Z.Bilbil Jonuz Kastrati shtetas shqiptar, i lindur më 04.08.1976 në Brrut, Shqipëri person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kartë identiteti Nr.H60804113C.

Z.Dashamir Guza shtetas shqiptar, i lindur më 17.06.1974 në Shijak, Shqipëri person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kartë identiteti Nr.H40617053M.

Të cilët kanë vendosur themelimin e shoqërisë **D & BILL SHPK** shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqeria **D & BILL SHPK** është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqipëtar. Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare përfaqësimi dhe agjenci në Shqipëri edhe jashtë shtetit.

**NENI 2**  
**Emri i shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **D & BILL SHPK**

**NENI 3**  
**Objekti i veprimtarisë**

Shoqeria ka për objekt - në përputhje me kërkesat ligjore - veprimtaritë e mëposhtme:

Tregtim me shumicë dhe me pakicë; hoteleri turizëm; ndërtim të ndërtesave për banim; blerje dhe shitje pasuri të paluajtshme dhe luajtshme; blerje dhe shitje mjete motorike, automjete dhe makineri.

**NENI 4**  
**Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Autostrada Durrës - Tiranë, Km.14, Truall me Nr.Pasurie 257/4, Zona Kadastrale 3974, Vol.6, Faqe 39, Vorë, Tiranë Shqipëri.

**NENI 5**  
**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 200 (dyqind) lek, dhe eshte i ndarë në 2 kuota.

Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

Z.Bilbil Kastrati 1 kuotë, me vlerë 100 Lekë, zotëron 50%

Z.Dashamir Guza 1 kuotë, me vlerë 100 Lekë, zotëron 50%

**NENI 6**  
**Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

**NENI 7**  
**Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjlt nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratorët .

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetëm i cili do të zgjidhen me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përvep rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

**Administratori i Shoqërisë pranon të jetë:**

Z.Dashamir Guza shtetas shqiptar, i lindur me 17.06.1974 ne Shijak, Shqiperi person madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me karte identiteti Nr.H40617053M.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternativë:

a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit

b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

### **NENI 8**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe Statutit.

### **NENI 9**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë pér dëmet që i janë shkaktuar pér faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

### **NENI 10**

#### **Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e shoqërise rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga Ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### **NENI 11**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelin e Shoqërise do të zgjidhen nga Ortakët, në rast të kundërt do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

### **NENI 12**

#### **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua nga Ortakët Themelues të cilët e gjeten atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruajnë pa vërejtje.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**Z.BILBIL KASTRATI**

*Bilbil Kastrati*

**Z.DASHAMIR GUZA**

*Dashamir Guza*